

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission
d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Legjislatura e –II–
KOMISIONI PËR BUJQËSI, PYLLTARI,
ZHVILLIM RURAL, MJEDIS DHE PLANIFIKIM
HAPËSINOR

Procesverbal Nr. 84
nga mbledhja publike e mbajtur më **10.10.2007**
kryesuar nga **Lulzim Zeneli**-nënkryetar i komisionit
Mbledhja filloi në orën 13,00

Të pranishëm :

1. Lulzim **ZENELI** nënkryetar-I
2. Fetah **BERISHA**
3. Jusuf **SUTAJ**
4. Shaban **HALIMI**
5. Zyhrrie **MALOKU**
6. Berat **LUZHA**
7. Sadudin **BERISHA**
8. Selvije **HALIMI**
9. XHelal **CANZIBA**

Munguan :

10. Rifat **KRASNIÇ** kryetar
11. Afrim **ARZUALLXHIU**
12. Gazmend **MUHAXHERI**
13. Goran **BOGDANOVIĆ**-nënkryetar-II-
- 14.

TË FTUARIT : Komisioni i Shëndetësisë , Ministri Sadik Idriz, Qaush Kabashi,
Flamur Kadriu dhe Shefki Zeqiri

RENDI I DITËS U MIRATUA PA VËREJTJE :

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i projektligjit për Ushqimin
3. Të ndryshme

Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Kryesuesi hapi mbledhjen dhe konstatoi se lidhur me pikën 1 nuk ka vërejtje.

Shqyrtimi i Projektligjit për Ushqimin

Kryesuesi Lulzim Zeneli në fillim përshëndeti të pranishmit dhe anëtarët e komisionit të Bujqësisë dhe Shëndetësisë. Ai në fillim konstatoi se ky është takimi i dytë i këtyre dy komisioneve, por kjo e sotme mund të definohet si e llojit të dytë, ngase sot dy komisionet prapë do të bëjnë përpjekje të përbashkëta për harmonizimin e qëndrimeve sipas kërkesës së kryesisë së Kuvendit. Ai njoftoi se komisioni për bujqësi ka shqyrtuar edhe një herë amendamentet e veta dhe ka rekomanduar ato që janë dorëzuar herën e fundit në Kuvend, njëherit janë dhënë mendimet për secilin amendament të komisionit për shëndetësi për përkrahje apo jo nga ana e këtij komisioni. Ai citoi rregulloren 2001/19 për kompetencat e MBPZHR të cilës i takojnë kompetencat në masën më të madhe ndaj këtij projektligji, ndaj përfundimisht komisioni tani pret vendimin e seancës plenare për dy koncepte lidhur me këtë projektligj, përfundoi ai.

Fatmire Kollqaku përsëriti qëndrimet e mëhershme të komisionit për shëndetësi të cilat janë në kundërshtim me ato të komisionit për Bujqësi, por nuk do të thotë se nuk mund të zgjidhen ato në takimin e sotëm. Ajo potencoi se qëndrimet kundërthënëse kanë sidomos dy ministritë (MSH dhe MBPZHR) të cilat janë zgjedhur me qëndrimin e Qeverisë e cila është pajtuar që Agjensioni për Ushqimin vendin të ketë në zyrën e kryeministrit, çka njëherit paraqet kompromisin e komisionit për shëndetësi, ajo shpresoj se nga ky takim do të sugjerohet seanca plenare si të veproji.

Në këtë takim u dëgjuan mendimet si vijon :

Lulzim Zeneli u pajtua se Qeveria është ajo që ka orientuar veprimet e saja me qëndrimin e cekur, mirëpo parlamenti është ai që përfundon një çështje meritorisht, çka edhe ka kërkuar komisioni për Bujqësi.

Sadik Idriz theksoi se problemi është ushqimi në tryezë, komisioni për bujqësi kontrollon ushqimin para se të arin ushqimi në tryezë, por jo edhe në tërësi. Kjo është kështu në shumicën e vendeve evropiane, përfundoi ai duke dyshuar se mund të zgjidhet ky problem në takimin e sotëm.

Naim Jerliu u fokusua në rolin e GP të cilat kanë sugjeruar një përpjekje të përbashkët. Komisioni për shëndetësi ka argumentet e veta të cilat mund të shtjellohen sot në bazë të vendimeve politike për zgjidhje të mundshme por jo me konfuzion. Z. Jerliu me z. Zeneli komentuan kërkesat e kryesisë e cila kërkon procedim të mëtejshëm të projektligjit me përpjekje të harmonizuara. Lulzim Zeneli insistoi në qëndrimin e komisionit për Bujqësi ngase kompetencat i takojnë pikërisht këtij komisioni.

Selvije Halimi konstatoi se Qeveria po zhargit ndërsa populli vuan për shkak të ushqimit jokualitativ, ajo insistoi për një vendim profesional (jopolitik), ndaj si kompromis i takimit të sotëm propozoi të themelohet një Agjension i ushqimit

plotësisht i pavarur si nga zyra e kryeministrit ashtu edhe nga MBPZHR. Shtetet e ndryshme rregullojnë këtë çështje ashtu si ju konvenon atyre, kurse Kosova këtë nuk mund të bëjë, parashtrohet pyetja pse ?

Shefki Zeqiri theksoi se MBPZHR është sponzor i këtij projektligji, ndaj një vendim që është në kundërshti me këtë fakt do të sjell situatë kontraproduktive.

Flora Brovina pyeti si mundet një ministri të propozoi një nen (36) nëse nuk ka kompetenca për atë. Agjensioni në fjalë duhet të jetë i veçantë në mënyrë që të pavarësohet nga interesat e dy ministrive.

Shefki Zeqiri : “shikojeni nenin 5 të Ligjit për Veterinarinë”.

Naim Jerliu : “lexoje të dëgjojmë” (Koment nga zyrtari i komisionit : Ky nen thekson Shërbimin e Veterinarisë por menjëherë në vazhdim e emërton si agjension).

Fatmire Kollqaku : “atëherë si keni mundur të propozoni nenin 36 kur ajo po ekzistojka, pse jemi mbledh sot, pasi ekziston agjensioni atëherë po e përmbysim këtë punë”. Ajo vazhdoi : “si është e mundur me marr një departament të tërë e me fut diku tjetër (inspektorati).”

Lulzim Zeneli : “Shikojeni nenin 39, këto janë argumente në favor të MBPZHR”.

Qaush Kabashi argumentoi për nenin 5 se ka të bëjë me veprimet që i takojnë vetëm Ministrisë së Bujqësisë ndërsa **Sadik Idriz** kundërshtoi se ajo mund të kryej punët e duhura që i takojnë ushqimit dhe kundërshtoi se këtu ka qëllime të caktuara.

Nurishahe Hulaj kërkoi ushqim të shëndosh, çka mund të garantohet vetëm nga Qeveria, ky ligj po bëhet për popullin, jo për ministrinë.

Lulzim Zeneli : “Vetëm parashtrone pyetjen pse nuk bënë agjensioni të jetë në kuadër të MBPZHR ose në kuadër të zyrës së kryeministrit, dhe do të vini në përfundim, shumë thjeshtë”.

Berat Luzha : “unë jamë distancua nga vendimi i komisionit tim sepse jam për agjensionin në kuadër të kryeministrit, por kjo nuk është problem, problem është se si një Qeveri nuk mundet ti zgjedhi problemet në brendi, midis dy ministrive, kjo po ndodhë edhe me parqet nacionale, andaj po këmbënguli se Qeveria është në krizë, me vite të tëra po ballafaqohemi me mosmarrëveshje të tyre”.

Nafije Berisha insistoi në një agjension në nivel të Qeverisë e cila do të caktoj rolën e dy ministrive me anë të laboratorëve referent etj

Flamur Kadriu potencoi kompromiset që i ka bërë MBPZHR në favor të agjensionit për ushqimin, ndaj ligji duhet ti definoi lidhjet që duhet të harmonizohen.

Ferid Agani : “ju pyes kush e kontrollon ujin, ajrin dhe ushqimin” (dy të parat ai theksoi se i kontrollon Instituti kombëtar i Shëndetësisë), ndaj si mundet të kontrolloi ushqimin MBPZHR” . Ai potencoi sa fjala është për shëndetin e qytetarëve. Ai kërkoi që ky ligj të kaloi në kompetencat e MSH, ndërsa rregullorja 2001/19 mund të realizohet me bashkëpunim. Kundërshtoi **Qaush Kabashi** i cili potencoi qartësinë e ligjeve të miratuara.

Lulzim Zeneli kërkoi një liberalizim të diskutimeve dhe qëndrimeve ngase si tha ai “jemi duke kërkuar kompromisin”.

Në vazhdim dy komisionet vazhduan me diskutime më tepër konfrontuese sesa harmonizuese, ndaj nga ky takim doli :

SUGJERIMI : Dy komisionet të vazhdojnë me përpjekjet, secili në veçanti, të rishikojnë amendamentet e deritashme që kanë hartuar, dhe në fund të propozojnë sërish një takim të përbashkët.

Takimi përfundoi në orën 15,15

Bajram Badivuku z.l.l.

Kryesuesi i komisionit,
Lulzim Zeneli

Vërejtje : Zyrtari i këtij komisioni ka pasur një takim tjetër në ndërkohë, ndaj nuk janë përfshirë në këtë procesverbal të gjitha diskutimet, por si u tha më lartë ato nuk kanë sjellë rezultatin të cilin e ka kërkuar Kryesia e Kuvendit. Kolegu i komisionit tjetër do të hartoj procesverbalin e komisionit për shëndetësi, ku mundeni edhe aty të njoftoheni.

